



Autoriteti Kontraktues:
Bashkimi i Bizneseve të Shqipërisë - BiznesAlbania

Udhëzimet për Aplikantët (UpA)

Për Thirrjen për Propozime (ThpP)

“Skema mbështetëse e granteve të vogla tek përfituesit e fundit - Grante për sipërmarrësit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me qëllim forcimin e potencialeve ekonomike dhe turistike të liqenit të Shkodrës dhe të rajonit ndërkufitar Mali Zi –Shqipëri”

Afati i fundit për dorëzimin e plotë të aplikimit: 22/05/2015



Përmbajte

“Skema mbështetëse e granteve të vogla tek përfituesit e fundit - Grante për sipërmarrësit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me qëllim forcimin e potencialeve ekonomike dhe turistike të liqenit të Shkodrës dhe të rajonit ndërkufitar Mali Zi –Shqipëri”

1.1 Parathënie

1.2 Objektivat dhe prioritetet e thirrjes

1.3 Alokimi financiar ofruar nga Autoriteti Kontraktor

2 Rregullat për këtë thirrje për propozim

2.1 Kushtet e Pranueshmërisë

2.1.1 Pranueshmëria e aplikantëve: Kush mund të aplikojë.

2.2 Si mund të aplikoj dhe procedurat që duhet të ndjek

2.2.1 Formulari i aplikimit dhe dokumentat mbështetës.

2.2.2 Ku dhe si dërgohet aplikimi?

2.2.3 Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit.

2.3 Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktor

2.3.1 Përmbajtja e vendimit

2.3.2 Kohëzgjatja për realizimin e kësaj ftese

3. Lista e anekseve





This project is funded by
The European Union



LakeRoutes.com

Cross Itineraries for the Tourism System Empowerment
and Economic Development - Shkodër Lake



ALBANIA - MONTENEGRO
IPA Cross Border Cooperation Programme



BIZNESALBANIA

ZEMË I BIZNESIT TË SHQIPËRIE

THIRRJE: “Skema mbështetëse e granteve të vogla tek përfituesit e fundit - Grante për sipërmarrësit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me qëllim forcimin e potencialeve ekonomike dhe turistike të liqenit të Shkodrës dhe të rajonit ndërkufitar Mali Zi –Shqipëri”

1.1 Përmbajtja

Projekti: “Itineraret ndërkufitare për fuqizimin e sistemit turistik dhe zhvillimin e turizmit - Liqeni Shkodrës” është financuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet Programit Ndërkufitar: SHQIPERI - MALI ZI 2007 - 2013, Alokimi Vjetor IPA 2010 - 2011, Referencë: EuropeAid/133455/M/ACT/Multi.

Zbatuesit kryesor të projektit janë BiznesAlbania në Shqipëri dhe Federata e Punëdhënësve të Malin të Zi. Periudha e realizimit të projektit është 24 muaj: 25.11.2013 - 25.11.2015. Në nivelin kombëtar partnerë në projekt janë Zyra e Shërbimit Turistik dhe partneri kombëtar nga Mali Zi Drejtoria për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme të Malit të Zi dhe Agjensia e Punësimit të Malit të Zi.

Objekti i përgjithshëm i projektit është të sigurojë një ofertë turistike kulturore të vazhdueshme nëpërmjet krijimit të një klime ekonomike pozitive për përfshirjen e një zone të gjerë në flukset turistike, siç është fuqizimi i kapaciteteve të grupeve të synuara në të dyja rajonet, në Shqipëri dhe Mali Zi. Me qëllimin e mirë për arritjen e objektivave të përgjithshme, objektivat specifike të treguara në zona të detajuara do të sjellin përmirësime me realizimin e projektit.

Me qëllim të shpërndarjes sa më të mirë të informacionit për grupet e synuara dhe audiencën në lidhje me projektin është zhvilluar dhe faqja e internetit: www.lakeroutes.com.

Aktivitetet kryesore të projektit janë:

- ✓ Menaxhimi i projektit, koordinimi dhe takimet me partner
- ✓ Zhvillimi i marketingut territorial dhe plani i menaxhimit për liqenin e Shkodrës
- ✓ Edukimi në marketing/ ndërtimi i kapaciteteve



- ✓ Vizita ndërkufitare ndërmjet dy rajoneve Shqipëri dhe Mali i Zi
- ✓ Krijimi i një modeli novator i ofertës turistike për liqenin e Shkodrës
- ✓ Grante për SME-të
- ✓ Dita e promovimit të turizmit
- ✓ Panair
- ✓ Promovimi i Liqenit të Shkodrës si një destinacion turistik dhe oferta turistike e re.

Me këtë aktivitet, grupi i punës i projektit dhe partnerët fillojnë zbatimin e një nga aktivitetet kryesore të projektit dhe kjo është skema e granteve të vogla për përfituesin përfundimtar - grante për sipërmarrësit, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me qëllim për të forcuar potencialin ekonomik turistik në liqenin e Shkodrës dhe rajonit ndërkufitar Mali Zi – Shqipëri.

OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET E THIRRJES

Objektivat Kryesore:

- Forcimi i sipërmarrjes private rreth Liqenit të Shkodrës dhe në rajonin ndërkufitar
- Rritja e produkteve dhe përmirësimi i ofertës turistike të Liqenit të Shkodrës dhe rajonit ndërkufitar
- Intensifikimi i aktivitetet promovuese dhe krijimi i materialeve promovuese nga territori i Liqenit të Shkodrës dhe zonave fqinje.
- Përmirësimet ekzistuese dhe përvetësimi i aseteve të reja fikse në mënyrë për të rritur aktivitetet e biznesit të biznesmenëve nga kjo fushë.
- Forcimi i sipërmarrjes
- Forcimi i kapaciteteve të punëtorëve artizanal, artisanëve dhe subjekteve të tjera përkatëse të cilat kontribuojnë në ofertën më të mirë turistike dhe kulturore të këtij rajoni.





This project is funded by
The European Union



LakeRoutes.com

Cross Itineraries for the Tourism System Empowerment
and Economic Development - Shkoder Lake



ALBANIA - MONTENEGRO
IPA Cross Border Cooperation Programme



BIZNESALBANIA

ZEMI I BIZNESIT TE SHQIPERISE

1.3 ALOKIMI FINANCIAR OFRUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

Shuma e Grantit

Çdo kërkesë për grant nën këtë thirrje për propozim duhet të bëhet në shumën e përcaktuar si më poshtë:

- Shuma Maksimum : 2.000 Euro

Autoriteti Kontraktues do të jap deri në 10 grante.

2. Rregullat për këtë thirrje për propozim

Ky udhëzues vendos rregullat për paraqitjen, përzgjedhjen dhe zbatimin e operacioneve financiare nën këtë Thirrje.

2.1.1 Pranueshmëria e Aplikantëve: Kush mund të aplikojë:

- Biznesi i regjistruar në Qarkun e Shkodrës i cili zhvillon aktivitetin e tij në rajonin e Liqenit të Shkodrës dhe rajonin ndërkufitar;
- Biznesi përgjegjës drejtpërdrejt për përgatitjen dhe menaxhimin e programit të punës me partnerë jo duke vepruar si një ndërmjetës dhe
- Sipermarres me përvojë dhe i aftë të demonstrojë kapacitetin për të menaxhuar projektin që ata paraqesin për grant;

Sektorët

Propozimet mund të përfshijnë programet për forcimin e ofertës turistike në Liqenin e Shkodrës dhe në zonat kufitare dhe programet për fuqizimin ekonomik të rajonit të Liqenit të Shkodrës dhe zonave fqinje.

Vendndodhja

E gjithë rishpërndarja e grantit DUHET të përdoret në Liqenin e Shkodrës ose në rajonin ndërkufitar ose me qëllim zhvillimin e produkteve/shërbimeve të cilat do të shpërndahen në këtë rajon.



Grupet e synuara:

Grupet e synuara për këtë thirrje janë bizneset të cilat janë të regjistruara në Qarkun e Shkodrës ose ushtrojnë aktivitetin e tyre në rajonin e Liqenit të Shkodrës dhe rajonin ndërkufitar.

- a) Operatorët dhe agjencitë turistike turistike,
- b) Artizanët, zanatçinjtë, prodhuesit e suvenireve të cilët bëjnë biznes në zonën e përmendur ose produktet e tyre promovojnë dhe zhvillojnë ofertën turistike në këtë rajon,

Rezultatet e pritura:

- ✓ Shtimi i numrit të itinerareve turistike rreth liqeni të Shkodres dhe rritjen e vizitorëve turistik
- ✓ Rritja e aktiviteteve ekonomike në zonën e synuar .
- ✓ Rritja e numrit të përdoruesve të shërbimit/turistët .

2.2 SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË NDIQEN

2.2.1 Forma e aplikimit dhe dokumentat mbështetëse

Forma e Aplikimit

Aplikimi përmban:

- Formularin e aplikimit të paraqitur;
- Dokumentat plotësuese;
 - 1- Kopje NIPT-i;
 - 2- Ekstrakti nga QKR

Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

2.2.2 KU DHE SI DËRGOHET APLIKIMI

Aplikimet duhet të dorëzohen me zarf në adresën e mëposhtme :





This project is funded by
The European Union



LakeRoutes.com

Cross Initiatives for the Tourism System Empowerment
and Economic Development - Shkoder Lake



ALBANIA - MONTENEGRO
IPA Cross Border Cooperation Programme



BIZNESALBANIA
ZEMË I BIZNESIT TË SHQIPERISË

Adresa Postare

BiznesAlbania

Rr. "Marko Bocari", Nd.6,

H.1, Nr.1, Tiranë

Dorëzimi me dorë:

BiznesAlbania

Rr. "Marko Bocari", Nd.6,

H.1, Nr.1, Tiranë

Zyra lokale e BiznesAlbania

Lagja Xhabia,

Rr. Zogu I

Shkoder

Aplikimet e dërguara me çfarëdo mënyre tjetër (p.sh. me faks ose me vetëm e-mail) ose të dërguara në adresë tjetër do të refuzohen.

Aplikimet duhet të dorëzohen në original ose te noterizuar dhe nje kopje..

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shkruhet:

- ✓ Titullin e Thirrjes për Propozimin,
- ✓ Emrin e plotë dhe adresën e aplikantit
- ✓ dhe fjalët "Të mos hapet para sesionit të hapjes"

Aplikimet jo të plota do të refuzohen.

2.2.3 Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është **më 22/05/2015 në orën 16.00**, siç dëshmohet nga data e dërgimit, vula postare ose nga data e dëshmisë së depozitave.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit të fundit automatikisht do të refuzohen.



2.3 NJOFTIMI I VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

2.3.1 Përmbajtja e Vendimit

Aplikanti do të informohet me shkrim për vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aplikimin e tij dhe, nëse është refuzuar, arsyet për vendimin negativ.

2.3.2 Kuadri kohor për realizimin e kësaj thirrje

Aktiviteti	Date
Lancimi i Thirrjes për Propozimin	07/04/2015
Afati i fundit për pyetje nga ana e aplikantëve	08/05/2015
Afati për sqarim nga Kontraktori	15/05/2015
Afati i fundit për dorëzimin e projektit propozimeve	22/05/2015
Vendimi për vlerësimin e granteve	29/05/2015
Firmosja e kontratës	05/06/2015
Fillimi i zbatimit të projektit	06/06/2015
Raporti përfundimtar dhe vlerësimi	10/10/2015

3. Lista e Anekseve

Aneks A : Forma e Aplikimit





This project is funded by
The European Union



FORMULAR APLIKIMI

Emri i aplikuesit:

Veprimtaria qe ushtron:

NIPT:

Adresa:

Propozimi per te perfituar grant:

Vlera e grantit te kerkuar:

Dokumentat e kerkuara:

- 1) Formulari i aplikimit
- 2) Ekstrakt i QKR
- 3) NIPT
- 4) Propozimi per grant

Date _____.____.2015

Subjekti

